



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 58 Prot

Tiranë, më 20.05.2008

VENDIM Nr. 10 dt. 20.05.2008

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.05.2008, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës.

VENDOSI:

I. Të miratojë projektet e restaurimit:

1. Restaurim i kompleksit Teqeja e Frashërit.
2. Konservimi dhe rikonstruksioni i Manastirit Apollonisë.
3. Restaurim Kalaja e Prezës, Tiranë.
4. Bazilika paleokristiane e Linit, Pogradec.
5. Restaurim Kalaja e Himarës.
6. Mirëmbajtje monumentet e kulturës komuna Petrelë dhe Dajt.
7. Ndërhjyje konservuese dhe restauruese në Antigone.
8. Kalaja e Grazhdanit, Dibër.
9. Kisha Shën Ilia, Voskopojë.
10. Xhamia e Fatihut, Durrës.
11. Projekt restaurimi për qendrat arkeologjike në Finiq dhe Cukë, Sarandë.
12. Restaurim Afresket në Bazilikën paleokristiane, Elbasan.
13. Restaurim Afresket e Kishës së Shën Prodhomit Voskopojë, Korçë.
14. Restaurim Kisha e Shën Nikollës, Voskopojë.
15. Restaurim Kisha "Fjetje e Shën Mërisë", Voskopojë.

II. U miratuan kërkesat:

1. Projekt përshtatje ish dyqanit të këpucëve (ndryshim funksioni) e Z. Kujtim Zenunaj, Berat.
2. Kërkesa e Ylli Trajçe, Korçë.
3. Projekti i ndërtimit të teleferikut në Kalanë e Rozafatit, Shkodër. (Projekti u miratua, me kushtin që stacioni mbërritës të vendoset jashtë mureve të kalasë).
4. Projekti i restaurimit të Qendrës Historike të Shkodrës (rruga). (projekti u diskutua dhe u aprovuan vërejtjet e bëra nga IMK:
 - rruga të kthehet në rrugë këmbësore, e shtruar me rrasa guri të rregullta vendi,
 - rruga të vendoset në qendër, konturuar nga 2 kuneta, të cilat kufizojnë hapësirat e trotuareve (mbi bazën e dokumentacionit fotografik të vjetër)
 - ndriçimi të jetë në mes të rrugës, shoqëruar me saksi dhe stola të lëvizshëm.
 - të eliminohen lulishtet dhe basenet ujore.

Gjithashtu, ju la detyrë IMK të bashkëpunojë me grupin e projektimit të Bashkisë, për përgatitjen e versionit përfundimtar).

III. Nuk u miratuan kërkesat:

1. Projekt rikonstruksioni i banesës së Z. Durim Nepravishtës (zonë tampon), Berat.
2. Projekt përshtatje e objektit Vasil Merdani (zonë tampon), Berat.
3. Projekt rikonstruksioni, banesa e Dobërdakëve, Shkodër. (Diskutimi i projektit shtyhet, deri në miratimin e rregullores)

IV. Lidhur me projektet:

1. Projekt i vizitueshmërisë në Bazilikën Arapaj, Durrës.
2. Projekt i vizitueshmërisë në Memorialin e Skënderbeut.

Hartimi i projekteve do të nënshtrohet një konkursi.

V. Nuk u diskutuan

A) Kërkesat

1. Restaurimi i banesës Thanas Dino, Gjirokastrë.
2. Restaurimi i banesës Stefan Tushe, Gjirokastrë.
3. Lokal Lagjja "11 Janari", pronar; Dashnor Mullai, Gjirokastrë.
4. Restaurim banese Halil Ymer Myderrizi, Durrës.
5. Vila 2 kate, pronar Fatmir Lama, lagja Kala, Elbasan.
Pritet të vijjnë kërkesat nga DRMK-të përkatëse.

B) Diskutimi i rregullores për zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në restaurim.

C) Kërkesat për licensë:

VI. U miratua propozimi për shpallje monument kulture:

1. Shtëpia e Gjergj Fishtës.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
YLLI PANGO**

SEKRETAR I K.K.R.

LORENC BEJKO

